



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Duke u bazuar në nenin 17 shkronja i) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 37 paragrafi 1.9, nenin 38. paragrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr.16-126211 të datës 06.11.2014, e me kërkesë të Lëvizjes Qytetare “Vatra”, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e të mbajtur më 26.05.2015, miratoi këtë:

REKOMANDIM

1. I Rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës-Ministritë për Punë të Brendshme me sa vijon:
 - Zbatimin e plotë të Rezolutës Nr.04-R-011 të datës 06.06.2013, të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës,
 - Qytetarëve të Kosovës Lindore t’u njihet e drejta për shtetësi, pasi që jetojnë prej vitit 1999 në qytetin e Gjilanit (ngase të gjithë janë dëbuar dhunshëm nga vatrat e tyre në qershor të vitit 1999).
 - Të nxirret një udhëzimi administrativ, i cili do të krijojë lehtësira procedurale, që qytetarët e Kosovës Lindore (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja) të pajisen me dokumente të Kosovës, e në të cilin UA përveç tjerash të përshkruhen:
 - a. të mos kërkohet nga aplikuesit garancioni bankar prej 6,000.00€
 - b. të mos kërkohet sigurimi shëndetësor.
 - c. të mos kërkohet vula apostile.
 - d. të mos kërkohet pasaporta e Serbisë.
 - e. të mos u kërkohet vërtetim që është apo nuk është nën hetime në Serbi.
2. Aplikuesëve si element të dëshmisë që janë duke jetuar në Komunën e Gjilanit prej vitit 1999, t’u kërkohet: Tatimi në pronë, vërtetimi i shkollimit të fëmijëve në Kosovë, Kontrata mbi qiranë etj.

KUVENDI I KOMUNË-GJILA N

01.Nr. 016-49468
Gjilan, më 26.05.2015

Kryesuesja e Kuvendit,

Valentina Bunjaku-Rexhepi